

Kush jemi ne?

REC - Reconciliation Empowering Communities, është organizatë joqeveritare e regjistruar në Kosovë dhe promovon zhvillimin e mëtutjeshëm të shoqëris Kosovare, duke angazhuar potencialin njerëzor në mesin e komuniteteve të ndryshme.

OJQ REC është fokusuar në demokratizim, sundim të ligjit, të drejtat e njeriut dhe fuqizim të komunitetit përmes qytetarisë aktive. REC shtrinë veprimtarinë e saj në rajonin e Mitrovicës dhe më gjerë.

OJQ REC është duke realizuar disa projekte në rajonin e Mitrovicës (në qytetet Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj), me bazë në komunitet pa dallim feje, race, gjinie apo kombësie.

Përmes këtij projekti OJQ REC do të ndihmoj komunitetin dhe institucionet në:

Adresimi e nevojave të qytetarëve rreth menaxhimit adekuat të deponisë së mbeturinave në Gërmovë të Mitrovicës,

Avokim tek institucionet komunale dhe qendrore, përmes analizës së thuktë mbi problemet që kjo deponi është duke shkaktuar,

Rekomandime të kjarta se si të veprohet më tutje.

Kjo fletushkë është realizuara në kuader të projektit, "Deponitë e mbeturinave – problem mjedisor akut" në përkrahje të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS.

Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtimi janë të Organizata jo-qeveritare "Reconciliation Empowering Communities – OJQ REC", dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e donatorit.



REC OJQ/NVO/NGO
Reconciliation Empowering Communities

Contact:

info@rec-kosova.org
rec.kosova@gmail.com

Rr. Xhafer Deva 40000
Mitrovicë, Kosovë

www.rec-kosova.org



DEPONITË QË PO SJELLIN PROBLEME!



MBËSHËTETUR NGA :  **KFOS**
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

MBËSHËTETUR NGA :  **KFOS**
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

A e dini se?

Deponia mbeturinave (në Gërmovë) fshati Koshtovë, ndodhet 7 km larg nga qendra e qytetit të Mitrovicës!



Në këtë deponi gjatë një dite hudhen deri në 150 tonë mbeturina të pa kontrolluara dhe selektuara nga kopania regjionale e komunave të Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderajit.

Deponia për rajonin e Mitrovicës është e vendosur në malin e Gërmovës, në fshatin Koshtovë dhe madhësia e saj është 7 hektarë me kapacitet prej 2 milionë metrash kub.

Mbeturinat që deponohen aty nuk ngjishen, mungon trajtimi i kullimit të ujërave dhe nuk ka menaxhim të gazit.

Gypi kryesor i kanalit Ibër-Lepenc kalon në mes të deponisë, kanal ky që furnizon 70% të territorit të Kosovës me ujë.

Shkaku i rrjedhjes së gazit dhe ndotjes së ujit dhe ajrit, uji i pijshëm me rrjedhje të lirë për fshatin Koshtovë tani është i papërdorshëm.

Uji i kontaminuar që rrjedh nga kjo deponi, kalon përmes një procke direkt në lumin Ibër i cili pastaj përshkon të gjithë qytetin e Mitrovicës!

Kompania Uniteti nuk mubulon rregullisht deponin!

Fshati Koshtovë dhe Koprivë janë fshtrat që ballafaqohen me shumë problememe nga kjo deponi!

Deponia e mbeturinave në Gërmovë, këto 10 vitet e fundit po sjell shumë probleme për banorët dhe bizneset e fshatërave përreth, e posaqërisht për fshatin Koshtovë dhe Koprivë.

Kjo deponi për ditë shkakton ndotjen dhe kontaminimin e ambientit, kundërmimi i ajrit rrezikon banorët dhe bizneset që banojnë në atë lokalitet nga sëmundjet infektive.

Përhapja e qenëve endacak të sjellur në deponi edhe nga qytetet tjera, shtimi i ujërave janë rrezikë i madh për banorët.

Përhapja e insekteve të njohura si bubashfaba është në nivel enorm. Gjithashtu, mizat dhe mushkonjat mund të përhapin sëmundje dhe epidemi shkaku i mos dezinfektimit.

Shumë ferma familjare si ne blegtori (ferma të lopëve dhe dhive) kanë deshtuar shkaku i mungesës së kullosës së pastër dhe përhapja e mbetjeve plastike ka ndikuar që bagëtitë të ngordhin.



Ka pasur vdekje enorme të bletëve, shkaku i ndotjes së ajrit dhe ujit.

Prodhimet bujqësore nuk janë të kultivueshme shkaku i kontaminimit të dheut, edhe ato që prodhohen janë të dëmshme për konsum.

Veprimtaria e njohur e peshkut, hoteleria dhe restorantet ekzistuese rrezikohen nga kundërmimi i ajrit që vije nga deponia.

Ka rritje të numrit të të sëmuarve kronik dhe sëmundje të tjera me rrezik për jetë.

Të drejtat e juaja!

Për çdo parregullsi ju si qytetar mund të raportoni tek institucionet përgjegjëse në komunën tuaj apo institucionet qendrore.

Ku mund të ankoheni si qytetar për këto probleme?

Komuna e Mitrovicës

Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit

0800 19400 (pa pagesë nga ora 08:00 – 22:00)

+383 28 532 104

komuna.mitrovica@rks-gov.net

Komuna e Vushtrrisë

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

0800 42000 (pa pagesë nga ora 08:00 – 22:00)

+383 38 200 42417

info.vushtrri@rks-gov.net

Komuna e Skenderaj

Drejtoria për Shërbime Publike

komuna.skenderaj@rks-gov.net

Kompaninë Regjionale KRM "Uniteti" në Mitrovicë

+383 28 532 319

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujrave

Divizioni për Mbeturina dhe Kimikate

+383 (0) 200 32 003

dkp.mmph@rks-gov.net